



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 15 MARS 2020**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 15. MARTA 2020. GODINE**

**MARS - MART
2020**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 07/L-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020.

Dnevni red

1. Drugo razmatranje Nacrt zakona br.07/L-001 o budžetskim podelama budžeta Republike Kosova za 2020.godinu.

Mbledhjen e drejtoi kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani.

KRYETARJA: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

Ministrat të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e thirrur sipas vendimit nr. 07 dhe 009, datë 14 mars 2020.

Në sallë janë të pranishëm 61 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë. Tani 62 bashkë me Kujtimin.

Po vazhdojmë me pikën e rendit të ditës. Fjalën e ka kërkuar deputeti Arben Gashi lidhur me rendin e ditës.

ARBEN GASHI: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së dhe Lëvizjes Vetëvendosje, propozoj plotësimin e rendit të ditës me shtimin e një pike si pikë e parë e rendit të ditës - Miratimi i rezolutës lidhur me bisedimet me Serbinë. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti deputet!

Ju njoftoj që për të futur këtë pikë si pikë të rendit të ditës duhet të votojnë dy të tretat e deputetëve të pranishëm. A ka nevojë për deklarime të grupeve parlamentare? Zoti Selimi, a pajtoheni me propozimin e zotit Gashi që ta futim në rend dite rezolutën për dialogun?

Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Patjetër që pajtohem.

KRYETARJA: Faleminderit! Grupi 6+. A ka nevojë për deklarim? Nuk e keni kërkuar fjalën.

Për njoftimin tuaj, debati lidhur me këtë pikë është shteruar herën e kaluar, që nënkupton që ka mbetur vetëm votimi pa përfunduar.

Në rregull! Atëherë, ju lus regjia dhe deputetët të përgatitemi për votim.

Edhe një herë, sa deputetë jemi në sallë, ju lutem? 63 deputetë janë në sallë.

Fillimisht votojmë për futjen në rend të ditës, që d.m.th. duhet nga 63 deputetë, dy të tretat e tyre të votojnë për.

Përgatitemi për votim! Jo, me elektronikë po votojmë! A jeni gati?

Përgatituni për votim për futjen në rend të ditës. Votojmë tash!

A ka ndonjë deputet pa kartelë? Edhe deputeti Fatmir Rexhepi.

Me 62 vota për, kjo rezolutë futet në rend të ditës.

Atëherë fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Votimi i rezolutës për dialogun, e propozuar nga grupet parlamentare të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës

E ftoj deputetin Arben Gashi që ta lexojë tekstin e rezolutës para se ta futim në votim.

ARBEN GASHI: Kuvendi i Republikës së Kosovës, në seancën e jashtëzakonshme të datës 11. 3. 2020, me propozimin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka propozuar këtë rezolutë, e cila ka mbetur në procedurë dhe mbetet që të aprovohet sonte:

R E Z O L U T Ë

1. Republika e Kosovës është e përkushtuar për bisedime politike ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë që do të rezultojnë me njohje reciproke.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës rithekson se Kushtetuta e Republikës së Kosovës, sovraniteti shtetëror, integriteti territorial dhe karakteri shtetëror unitar i Republikës së Kosovës janë të pacenueshme. Askush nuk ka të drejtë të bisedojë, të dialogojë apo të negociojë për sovranitetin, integritetin territorial, rendin kushtetues dhe karakterin unitar të Republikës së Kosovës.
3. Në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese nr. K043/19, datë 27 qershor 2019, është Qeveria e Republikës së Kosovës që e ka mandatin t'i udhëheqë bisedimet dhe/ose dialogun me Serbinë, si dhe të bëjë përgatitjet për negociatën e të negociojë lidhur me një marrëveshje të mundshme përfundimtare, e cila do të rezultojë me njohje reciproke ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, brenda vijave të patjetërsueshme të rendit kushtetues të Republikës sonë.

Ky është teksti. Ju ftoj që ta votoni. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Atëherë, i ftoj të gjithë deputetët që të ulen, të zënë vendet e tyre dhe të përgatiten për votim.

Faleminderit shumë, zoti deputet! Përgatitemi për votim për rezolutën e lexuar nga deputeti Arben Gashi.

Votojmë tash!

A ka votim edhe me dorë? Deputeti Fatmir Rexhepi, votoni për po supozoj z. deputet? Faleminderit!

Me 57 vota për dhe 5 abstenime, kalon rezoluta e propozuar nga grupet parlamentare të Lëvizjes Vetëvendosje dhe LDK-së lidhur me dialogun Kosovë-Serbi, e cila e autorizon Qeverinë e Republikës së Kosovës për t'i udhëhequr bisedimet me Serbinë. Faleminderit!

Procedojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 07/L-001 mbi ndarjen buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020.

Ju njoftoj se komisionet parlamentare në bazë të vendimit të Kuvendit nr. 07/V/009, datë 14 mars 2020, e kanë shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ndërsa Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve nuk e ka shqyrtuar brenda afatit të paraparë me vendimin e Kuvendit, datë 14 mars 2020. Prandaj, vazhdojmë në përputhje me praktikën e deritanishme të Kuvendit të Kosovës.

E ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Transfere, z. Murati, ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

HEKURAN MURATI: Të faleminderit, kryetare!

Meqenëse ende nuk e kemi marrë ne deputetët raportin me rekomandime, ndoshta të presim pak derisa të na e sjellin.

KRYETARJA: Në rregull!

HEKURAN MURATI: Atëherë unë e kam raportin me rekomandime. Po vazhdoj ta lexoj, e besoj vjen në ndërkohë edhe për deputetët që ta shohin.

Komisioni për Buxhet dhe Financa në bazë të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur, më 14 mars 2020, e shqyrtoi Projektligjin nr. 07/L-007 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, dhe vendosi të paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet Projektligji nr. 07/L-007 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, me amendamentet e propozuara, si në vijim:

Amendamentet në pjesën tekstuale të projektligjit, amendamenti 1, neni 11, në paragrafin 10, në rreshtin e 4-të dhe 8-të, dhe në tërë tekstin e projektligjit, teksti “Komisionin(t) për Buxhet dhe Financa” zëvendësohet me tekstin “Komisionin(t) për Buxhet dhe Transfere”.

Amendamenti 2, neni 12, paragrafi 8, në rreshtin e 2-të, pas fjalës “të tilla” shtohet teksti “për koston totale të projektit”.

Në vijim, kemi edhe amendamentet në pjesën tabelare të projektligjit, amendamenti 3, në organizatën buxhetore; Kuvendi i Kosovës me kod organizativ 101, bëhen ndryshimet, si vijon:

Në nënprogramin 10/100 anëtarë të Kuvendit, kategoria paga dhe shtesa, shuma 3 milionë e 710 mijë euro, ndryshohet në shumën 4 milionë e 110 mijë euro.

Në nënprogramin 10/200, Administrata e Kuvendit, numri i të punësuarve nga 199 ndryshohet në 214.

Në mënyrë që ta përshpejtojmë procesin, janë gjithsej 12 amendamente me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL dhe i kemi 4 amendamente pa përkrahjen e Komision FunkSIONAL.

I ftoj deputetët që amendamentet që e kanë përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL të votohen në paketë, në mënyrë që të kurset kohë, dhe pastaj amendamentet që janë pa përkrahjen e komisionit t'i shqyrtojmë veç e veç dhe të arsyetohen prej propozuesve.

KRYETARJA: Faleminderit, zoti deputet!

Atëherë, propozimi është që amendamentet 1 - 12, të cilat e kanë përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL të votohen në pako. A ka ndonjë kundërshtim? Meqenëse nuk ka kundërshtime, atëherë unë po procedoj menjëherë.

Ju lus të përgatiteni për votim. Zonja Besa Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Ju kisha lutur të gjithëve kolegë deputetë,

Meqë po shkon kështu dhe ende s'i kemi marrë amendamentet, pakoja e Komisionit të Buxhetit, mund të jetë amendamenti i njëjtë, ose e kundërshton ose shkojnë dy amendamente; edhe ai i buxhetit, edhe i deputetit, e pastaj bëhet puna lëmshe.

Ta kenë parasysh të gjithë deputetët! Ai amendamenti, i cili nuk ka kaluar në Komisionin e Buxhetit e votohet, na detyron që të shkojmë në leximin e tretë të buxhetit. Prandaj, paraparakisht ta keni të qartë secili deputet.

Ta keni parasysh, amendamenti që s'ka kaluar në Komisionin e Buxhetit dhe votohet pas kësaj pakoje, na detyron që ta çojmë ligjin në leximin e tretë, prandaj kini kujdes!

KYRETARJA: Faleminderit, zonja deputete!

Për momentin po i votojmë amendamentet 1 - 12, pra që të gjitha e kanë përkrahjen e komisionit. Ndërkaq, amendamentet 13 - 17 e shqyrtojmë secilin individualisht, dhe ju falënderoj shumë për sqarimin që ju e dhatë, për të cilin keni të drejtë.

Kryetari i komisionit, Hekuran Murati, edhe një herë!

HEKURAN MURATI: Një sqarim! Pra, është edhe amendamenti numër 15, që shkon me përkrahje të komisionit. Pra, janë vetëm amendamentet 13, 14, 16, 17, që nuk e kanë përkrahjen e komisionit.

KRYETARJA: Faleminderit! Fjala është për amendamentin 15, i propozuar nga deputetët Shkëlzen Hajdini, Vlora Limani-Hajnuni dhe Rreze Krasniqi. Pra, ky është me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Po supozoj që ka të bëjë me Lipjanin diçka. Në rregull, në cilindo rast e përkrahim.

Atëherë, votohen në pako amendamentet 1 - 12 dhe amendamenti 15. Ju lus të përgatiteni për votim. Regjia dhe deputetët, votojmë tash! Faleminderit!

I kemi 61 vota për, edhe 1 votë me dorë, 62 vota për. 1 votë kundër. Nuk ka abstenime.

Atëherë, kalojnë amendamentet 1 - 12 dhe amendamenti 15.

Procedojmë me amendamentin 13, i propozuar nga deputeti Shpejtim Bulliqi, por pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Zoti deputet, e dëshironi fjalën? Zoti Bulliqi e ka fjalën.

SHPEJTIM BULLIQI: Në mënyrë që të mos krijojmë telashe më tutje, unë do t'i tërheq të dyja amendamentet e mia. Shpresoj që në rishikimin buxhetor do t'i kemi parasysh këto të dyja.

KRYETARJA: Pra, fjala është për amendamentet 13 dhe 14. Që të dyja amendamentet tërhiqen nga propozuesi.

Kalojmë te amendamenti 16, i propozuar nga deputeti Dimal Basha, pa përkrahjen e komisionit. Zoti deputet, e dëshironi fjalën?

DIMAL BASHA: Po, kryetare!

S'është amendamenti 16, janë amendamentet 17 dhe 18. Amendamenti 16, me sa e kam këtu, është nga Valentina Bunjaku. Kështu që, veç ta dimë, a i jemi referuar... Aha, ky është raport tjetër. Në rregull!

Pra, për të mos u bërë problem kjo punë, edhe unë i tërheq këto dy amendamente.

KRYETARJA: Faleminderit! Në materialin që e kemi para nesh, janë amendamentet 16 dhe 17, të propozuara nga deputeti Dimal Basha. Që të dyja tërhiqen nga propozuesi. Rrjedhimisht, nuk kemi amendamente të tjera, dhe tani në qoftë se jeni gati, shkojmë me votimin e tekstit të projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim. A jeni gati? Atëherë, votojmë tash!

Gjithsej 62 vota janë për dhe 1 votë me dorë, 63 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Konstatohet se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 07/L-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020.

Dua ta falënderoj secilin prej jush për durimin për punën dhe për përkushtimin gjatë ditës dhe natës së sotme. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*